

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Arritja / *el-Wuxhuud* / الْوُجُود

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"يَجِدِ اللَّهُ غَفُورًا رَحِيمًا"، "لَوْجَدُوا اللَّهَ تَوَّابًا رَحِيمًا"، "وَوَجَدَ اللَّهُ عِنْدَهُ"

Allahu fuqplotë foli qartazi për emrin *wuxhuud*¹ në Kuran, kur tha: "... do të gjejnë Allahun falës dhe mëshirues" (en-Nisa, 110), "... do ta kishin gjetur Allahun si pranues të pendimit dhe si mëshirues" (en-Nisa, 64), "... por gjen Allahun para vetes." (en-Nur, 39)

Wuxhuud është një emër për arritjen e realitetit të një çështjeje. Kjo u referohet tri kuptimeve:

I pari është arritja e dijes *ledunn*² (tek Unë), që përmbyll dijen demonstrative³ me anë të zbulimit hyjnor autentik që të bëhet ty⁴.

¹ Ky emër është një emër foljor, që vjen nga rrënja *wexhede* (gjeti). Kjo ka të bëjë me gjetjen e Zotit ose realizimin e fundit të udhëtimit. Kjo është më shumë sesa të arrish Atë. Kjo është arritje (*wusuul*) dhe lidhje (*wesl*). Në *Medaarixh*, Imam Ibn el-Kajjim jep një shembull domethënës të *wuxhuud* (arritjes), kur përmend një njeri që synoi (*kasade*) arritjen e një thesari dhe mori udhë (*seleke*) për tek ai, derisa mbërriti (*wesele*) aty; por vetëm pasi ai do të mundte ta posedonte dhe ta merrte me vete në shtëpi do të mund të thuhej se e arriti (*wexhede*).

² Burimi i kësaj dijeje është vetë Zoti, i cili e vendos në zemrën e njohësit.

³ Jo që (dija e Zotit) e anulon, por e bën të zbehet në krahasim me të.

⁴ Dija demonstrative bazohet në prova. Kjo dije vjen nga Zoti, është bindëse dhe e papërmbajtshme, dhe është rezultat i zbulimit shpirtëror të përjetuar nga shikimi i zemrës. Kjo i referohet besimit të arritur me anë të përvojës, që është më i lartë sesa besimi i arritur vetëm nëpërmjet pranimit të tij si i vërtetë.

I dyti është arritja e njëmendtë e të Vërtetit; një lloj arritjeje që është e pavarur nga shenjat në rrugë⁵.

I treti është arritja e shkallës së zbehjes së arritjes nëpërmjet kredhjes në përparësinë⁶.

⁵ Sepse kjo është si të parit e syrit, prandaj dhe shenjat e rrugës nuk janë të nevojshme më për dikë që arrin në vendmbërritje.

⁶ Tash arritja jote e të Vërtetit bëhet mbizotëruese me kredhjen tënde në përparësinë e Tij, pasi që shpirti yt të ketë udhëtuar mbrapa në kohë, deri atëherë kur të gjitha krijesat nuk ekzistonin dhe ekzistonte vetëm Allahu. Kështu, ti kap atë çast dhe e lë të të përthithë, pastaj nuk sheh “një që arrin” dhe “një që arrihet”, por sheh vetëm Një, të Përjetshmin, të Vërtetën. Tërë kjo, siç kemi shpjeguar, është në fushën e koncepcioneve mendore.